



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE BUXHETIT



100 Vjet Pavarësi

NR 1892/6

14.06.12

UDHEZIM

Nr. 2/ date 14.06.2012
2

PER DISA SHTESA E NDRYSHIME NE UDHEZIMIN PLOTESUES Nr. 2/1 date 15.02.2012 " PER ZBATIMIN E BUXHETIT TE VITIT 2012 "

Ne mbështetje te pikës 4, te nenit 102 te Kushtetutës, ne zbatim te Nenit 38 te Ligjit nr. 9936, date 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë", nenit 19 te Ligjit Nr. 10 487 date 5.12.2011 " Per Buxhetin e vitit 2012", dhe ne vijim te udhezimit te Udhezimit te Ministrit te Financave Nr. 2 date 6.02.2012 " Per procedurat standarte te Zbatimit te Buxhetit", paragrafi 2, Ministri i Financave:

UDHEZON

Ne Udhezimin Plotesues nr. 2/1 date 15.02.2012 " Per zbatimin e Buxhetit te vitit 2012", behen keto shtesa:

1. Ne kreun I. " Proçedura specifike shtese per zbatimin e Buxhetit te Shtetit", pas pikes 4, te shtohet nje paragraf me permbajtjen:

" Vendimet gjyqesore qe lidhen me procesin e legalizimit te ndertimeve pa leje, ne zbatim te ligjit nr. 9482 date 3.04.2006 " Per legalizimin, urbanizimin e integrimin e ndertimeve pa leje", i ndryshuar, do te likujdohen me te ardhurat e realizuara nga transferimi i parceles ndertimore te cilat nuk jane transferuar ne llogarine e kompesimit te pronave."

2. Ne piken 14, shtohet germa h, me kete permbajtje:

" h. Te ardhurat e realizuara nga shitja e mallrave rezerve shteterore gjate procesit te freskimit te mallrave rezerve dhe qe perdoren per zevendesimin e mallrave te shitura."

3. Ne piken 15, germa b, riformulohet si me poshte:

“ b. Te ardhurat nga shtepite e pushimit te Ministrise se Brendshme, Sherbimit Informativ Shqiptar, si dhe te ardhura nga sherbimi i transportit te mjeteve te bllokuara (karrotreci) dhe te ardhura nga parkimi”.

4. Ne piken 15, shtohet germa c, me permbajtjen:

“ c. Te ardhurat nga privatizimi qe perdoren per likujdimin e detyrimeve qe rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqesore nga Ministria e Financave qe lidhen me procesin e privatizimit, si dhe per likujdimin e shpenzimeve te kryera per kete proces.”

5. Ky udhëzim hyn ne fuqi menjëherë.

Ridvan BODE


MINISTER